



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRI I FINANCAVE
NJËSIA QENDRORE E HARMONIZIMIT PËR AB
KOMITETI AUDITIMIT TË BRENDSHËM

M I R A T O H E T

RIDVAN BODE

MINISTËR I FINANCAVE

RREGULLORE

Nr. 24270, datë 29.12. 2011

PËR VEPRIMTARINË E KOMITETIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 14, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar me ligjin Nr.10318, datë 16.09.2010, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.680, datë 05.10.2011 për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.548, datë 1.5.2008 “Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm”, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, Ministri i Financave miraton rregulloren e veprimtarisë së Komitetit të Auditimit të Brendshëm, sa më poshtë:

PJESA E PARË

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i Rregullores

Kjo rregullore synon të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në veprimtarinë e tij si dhe raportet e ndërsjella ndërmjet Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

2. Statusi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm

Statusi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm(KAB) sipas nenit 12, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet si një organ këshillimor pranë Ministrisë të Financave dhe Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Komiteti propozon dhe këshillon në përcaktimin e strategjive dhe për përmirësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë. Anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm emërohen nga Ministri i Financave, në pajtueshmëri me përcaktimet e bëra në pikën 1 të Nenin 14, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar.

Pranë Komitetit të Auditimit të Brendshëm ka një sekretar. Sekretari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm caktohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, në pajtueshmëri me përcaktimet e bëra në pikën 2, të Nenin 14, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar.

PJESA E DYTË

RREGULLA MBI FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E KOMITETIT

3. Funkcionimi organizativ i KAB

Bazuar në pikën 2 të Nenin 14, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ndryshuar me ligjin Nr.10318, datë 16.09.2010, mandati i anëtarit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm zgjat për një periudhë 2 (dy) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Për të siguruar një funksionim sa më normal në veprimtarinë e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, zbatohen këto procedura:

1. Ministri i Financave ose, me porosinë e Tij, Drejtori i Përgjithshëm i Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, njofton anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, të sapoemëruar, për mbledhjen e tyre të parë, për të zgjedhur Kryetarin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm. Njoftimi bëhet me shkrim nëpërmjet sekretarit të komitetit ose personit të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i NJQH për AB, jo më vonë se 7 (shtatë), ditë pune nga data e miratimit të urdhërit të Ministrisë të Financave mbi emërimin e anëtarëve të KAB.

Në kohën e dërgimit të njoftimit për mbledhjen e parë të Komitetit, anëtarëve të ri të KAB, iu vihet në dispozicion paketa ligjore e nënligjore mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

2. Zgjedhjet zhvillohen sipas procedurave që miratojnë anëtarët e Komitetit dhe kryetari zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash, me votim të fshehtë. Kryetari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm nuk duhet të jetë punonjës i strukturave të auditimit të brendshëm. Mandati i tij zgjat 2 (dy) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Në rast se në mbledhjen e parë të Komitetit, anëtarët nga votimi nuk arrijnë të zgjedhin kryetarin e Komitetit të Auditimit, atëherë zhvillohet një votim i dytë.

- Për këtë qëllim zhvillohet një mbledhje tjetër e Komitetit të Auditimit të Brendshëm jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune pas votimit të parë dhe ndiqet e njëjta procedurë votimi për zgjedhjen e kryetarit.
4. Për raste të përfundimit të kohës së mandatit, anëtarët dhe kryetari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm, mbeten në detyrë deri në caktimin e anëtarit apo zgjedhjes së kryetarit të ri.
 5. Kryetari dhe çdo anëtar i Komitetit të Auditimit të Brendshëm, përgjatë periudhës së ushtrimit të mandatit, shkarkohet/lirohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Financave në rastet kur:
 - a) nuk kryen detyrën në pajtueshmëri me përcaktimet e bëra në Ligj;
 - b) nuk i përket më fushës apo nuk e ushtron më funksionin në institucionin nga i cili Ai është zgjedhur anëtar i KAB bazuar në pikën Nr.1 të nenit 14, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
 - c) mungon në mënyrë të paarsyetuar në tre mbledhje rradhazi;
 - d) kur jep dorëheqjen.
 6. Asnjë anëtar i Komitetit të Auditimit të Brendshëm, nuk mund të shkarkohet nga detyra për shkaqe dhe rethana të paparashikuara në Ligj dhe në këtë rregullore.
 7. Komiteti i Auditimit të Brendshëm e zhvillon veprimtarinë e tij vjetore sipas një kalendari të përcaktuar e të miratuar prej tij.
 8. Komiteti i Auditimit të Brendshëm mbledhet në seanca të zakonshme, jo më pak se një herë në tre muaj, ose katër herë në vit.
 9. Zakonisht mbledhjet e Komitetit të Auditimit të Brendshëm thirren nga kryetari i Komitetit nëpërmjet sekretarit të KAB, i cili njofton të gjithë anëtarët për datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet mbledhja e rradhës. Njoftimi përmban gjithashtu një listë të çështjeve që do të trajtohen dhe bëhet jo më vonë se 4 (katër) ditë pune para zhvillimit të mbledhjes për rastet kur ai dërgohet me postë elektronike, dhe jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune para zhvillimit të mbledhjes për rastet kur ai dërgohet me postë të zakonshme.
 10. Mbledhja drejtohet nga kryetari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm, dhe në mungesë të tij nga anëtari në moshë më të madhe.
 11. Në raste të veçanta mbledhja mund të thirret me kërkesë të:
 - a. Ministrit të Financave;
 - b. Drejtorit të Përgjithshëm të Njesisë Qendrore të Harmonizimit për AB;
 - c. së paku prej 3 (tre) anëtarëve të Komitetit, nga të cilët njëri nuk duhet të jetë punonjës i strukturave të auditimit të brendshëm. Në këtë rast mbledhja duhet të zhvillohet brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga depozitimi i kërkesës me shkrim.
 12. Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm është jo më pak se 6 (gjashtë) anëtarë.
 13. Vendimet e Komitetit të Auditimit të Brendshëm janë të vlefshme kur kanë votuar “pro” më shumë se gjysma e anëtarëve të komitetit.
 14. Gjatë zhvillimit të mbledhjes mbahen minutat e takimit (shënimet për çdo mbledhje) që pasqyrohen në një procesverbal, i cili, në përfundim të mbledhjes, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komitetit pjesëmarrës në mbledhje.

5. Detyrat e Komitetit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në Nenin 13, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ndryshuar me ligjin Nr.10318, datë 16.09.2010, detyrat e Komitetit të Auditimit të Brendshëm janë si më poshtë:

a) përgatitja dhe dhënia e vlerësimeve dhe mendimeve për metodat e auditimit të brendshëm, të propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm;

b) vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për kuadrin ligjor dhe rregullator, të hartuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në fushën e auditimit të brendshëm, në sektorin publik;

c) vlerësimi dhe dhënia e mendimeve për raportet tremujore dhe vjetore, të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në subjektet e audituara, të paraqitura nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm;

ç) këshillimi i Ministrisë të Financave dhe Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në të gjitha aspektet e planeve dhe të punës së auditimit të brendshëm, në përshtatjen e praktikave ndërkombëtare të auditimit, në cilësinë dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në subjektet e audituara;

d) këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për rishikimin e metodave, të procedurave dhe përshtatjen e standardeve të auditimit të brendshëm, të propozuara nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, përpara miratimit nga Ministri i Financave;

dh) kryerja e detyrave të tjera, të caktuara nga Ministri i Financave.

6. Të drejtat dhe detyrat e Kryetarit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm

Kryetari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm ka këto të drejta dhe detyra:

- Të organizojë punën për drejtimin e veprimtarisë së Komitetit të Auditimit të Brendshëm.
- Të organizojë punën për realizimin e veprimtarive të parashikuara në kalendarin e vjetore të punës për KAB.
- Të organizojë punën për bashkëpunimin me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor si dhe të metodave të auditimit të brendshëm dhe për të gjitha aspektet e planeve dhe raporteve progresive e vjetore të auditimit të brendshëm, dhe përshtatjen e praktikave ndërkombëtare të auditimit, duke ndihmuar në përmirësimin e cilësisë dhe funksionimit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.
- Të respektojë kalendarin vjetor të mbledhjeve si dhe të organizojë njoftimet për zhvillimin e mbledhjeve të Komitetit, në kohën e nevojshme, nëpërmjet sekretarit të KAB.
- Të monitorojë punën për përgatitjen dhe hartimin e vendimeve, protokollimin dhe dërgimin e tyre tek Ministri apo Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm lidhur me veprimtarinë e KAB.

7. Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm

Anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm kanë këto të drejta dhe detyra:

- Të marrin pjesë në të gjitha takimet e Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe të kontribuojnë me mendimet e tyre, për detyrat që parashikon ligji.
- Të bashkëpunojnë me kryetarin dhe sekretarin e komitetit si dhe me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm me qëllim që të realizohet veprimtaria e Komitetit si dhe të përmirësohet cilësia dhe funksionimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.

8. Të drejtat dhe detyrat e Sekretarit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm

Sekretari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm ka këto të drejta dhe detyra:

- Të bashkëpunojë me kryetarin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm për caktimin e rendit të ditës të mbledhjeve dhe bën njoftimin e anëtarëve të Komitetit për takimet (mbledhjet) e tij.
- Të bëjë njoftimet e mbledhjeve të Komitetit për rendin e ditës, datën e orën, dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes, pas miratimit të kryetarit të Komitetit, duke respektuar kërkesat e kësaj rregulloreje dhe duke iu dërguar anëtarëve të KAB materialet përkatëse.
- Të mbajë minutat e takimit gjatë mbledhjeve të komitetit.
- Të kujdeset për administrimin e dokumentacionit që lidhet me zhvillimin e mbledhjeve si dhe të protokollojë shkresat dhe vendimet për çdo mbledhje.

Njësia Qendrore e Harmonizimit për AB

Hysen MUCEKU

Drejtor i Përgjithshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Palok KOLNIKAJ

Kryetar

Konceptoi: Eneida Meneri, Specialist

Konfirmoi: Pjetër Ndreca, Drejtor